

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Gëzim LLulluni, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, të cilin e përfaqëson i autorizuari N.H., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës NP Hekurudhat e Kosovës Sh.a. "TRAINKOS" Fushë Kosovë, të cilën e përfaqësojnë të autorizuarat K.Th. dhe V.K., juriste pranë të t'paditurës, për shkak të anulimit të vendimit, kthimin në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C1.nr.21/2007, i datës 04.03.2014, në seancën jo publike të mbajtur me datë 20.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET ankesa e të paditurës NP Hekurudhat e Kosovës Sh.a. "TRAINKOS" Fushë Kosovë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C1.nr.21/2007, i datës 04.03.2014, ashtu që vendoset: REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A.M., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, me të cilën ka kërkuar që të anulohen vendimet e t'paditurës NP Hekurudhat e Kosovës Sh.a. "TRAINKOS" Fushë Kosovë - Aktvendimi i Komisionit Disiplinor Nr.1009/2, i datës 22.11.2006 dhe Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Lutjeve dhe Ankesave Nr.1151/2, i datës 27.12.2006, si jo të ligjshme dhe të detyrohet e paditura që paditësit për periudhën kontestuese t'ia njohë kompensimin e pagave nga data 26.11.2006 deri me 31.12.2013, shumën neto prej 24.445 Euro, kontributet për pension në shumë prej 1.222,25 Euro, si dhe tatimin në pagë në shumë prej 752,17 Euro, kurse nga 01.01.2014 e tutje shumën prej 297,25 Euro, deri në kthimin e paditësit në vendin e tij të punës ku ka punuar më parë si punëtor sigurimi në tren apo në punë tjera të ngjashme që i përgjigjen përgatitjes shkollore dhe aftësive punuese, SI E PABAZUAR.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C1.nr.21/2007, i datës 04.03.2014, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit A.M. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, i ka anuluar vendimet e të paditurës NP Hekurudhat e Kosovës Sh.a. "TRAINKOS" Fushë Kosovë, Nr.1009/2, i datës 22.11.2006 i Komisionit Disiplinor dhe i Komisionit për Ankesa nr.1151/2, i datës 27.12.2006, si jo i ligjshëm,

e ka detyruar të paditurën që paditësit për periudhën prej datës 26.11.2006 e deri me datë 31.12.2013, t'ia paguajë pagat (fitimin e humbur) në shumën neto prej 22.470,58

Euro, kontributin për pension 1.222,25 Euro, si dhe tatimin në pagë 752,17 Euro, ndërsa duke filluar prej 01.01.2014, e tutje për çdo muaj pagën neto nga 297,25 Euro, deri sa ta kthen paditësin në vendin e punës, ku ka punuar më parë, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 579 Euro, të gjitha në afatin prej 7 ditësh.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të prishte dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit me të cilën i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ankesën e të paditurës ta refuzojë si të pabazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 201 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A.M. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, përmes të autorizuarit të tij me datë 16.01.2007, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ka paraqitur padi kundër të paditurës NP Hekurudhat e Kosovës Sh.a. "TRAINKOS" Fushë Kosovë, të cilën e ka precizuar në seancën e datës 06.02.2014, dhe me të cilën ka kërkuar që të anulohen Aktvendimi i Komisionit Disiplinor nr.1009/2, i datës 22.11.2006 dhe Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Lutjeve dhe Ankesave Nr.1151/2, i datës 27.12.2006, si jo të ligjshme dhe të detyrohet e paditura që paditësit për periudhën kontestuese t'ia njohë kompensimin e pagave nga data 26.11.2006 deri me 31.12.2013 shumën neto prej 24.445 Euro, kontributet për pension në shumë prej 1.222,25 Euro, si dhe tatimin në pagë në shumë prej 752,17 Euro, kurse nga 01.01.2014 e tutje shumën prej 297,25 Euro, deri në kthimin e paditësit në vendin e tij të punës ku ka punuar më parë si punëtor sigurimi në tren apo në punë tjera të ngjashme që i përgjigjen përgatitjes shkollore dhe aftësive punuese. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C1.nr.21/2007, i datës 04.03.2014, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit me përshkrim si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar ka arsyetuar se nga provat e administruara dhe nga deklarimet e palëve nuk ka qenë rrethanë kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie të punës si dhe nuk ka qenë kontestuese legjitimiteti pasiv i të paditurës.

E paditura me aktvendimin e Komisionit Disiplinor Nr.1009/2, i datës 22.11.2006, e ka shpallur fajtor paditësin A.M. dhe i ka shqiptuar masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës, me arsyetim se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të

punës, që ka të bëjë me vjedhjen e naftës nga lokomotiva 007, datë 24.10.2006, kundër të cilit paditësi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Komisionin për Lutje dhe Ankesa pranë të t'paditurës i cili me vendimin e saj Nr.1151/2, i datës 27.12.2006, e refuzon si të pabazuar ankesën e paditësit A.M., ndërsa aktvendimin e komisionit disiplinor e vërtetojë.

Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se në procedurën e provave ka administruar edhe aktgjykimet penale të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr.67/2007, i datës 15.03.2011, me të cilin paditësi është shpallur i pafajshëm dhe është liruar nga akuza lidhur me veprën penale vjedhje e rëndë në bashkëveprim nga neni 253 paragrafi 1, nën paragrafi 1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së. Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AP.nr.1106/11, i datës 20.11.2012. Gjykata ka arsyetuar se e paditura aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, e ka marrë para se gjykata penale të marrë aktgjykimin e saj, prandaj edhe baza juridike e ndërprerjes së marrëdhënies së punës është rrëzuar në momentin e shpalljes së paditësit të pafajshëm.

Gjykata ka vlerësuar se aktvendimet e të t'paditurës janë të paligjshme për shkak se të njëjtat janë marrë para përfundimit të procedurës penale, kurse një gjë e tillë është dashur të merret pas përfundimit të procedurës penale, pasi që në rastin konkret çështja e ekzistimit të veprës penale apo mos ekzistimit të saj në procedurën disiplinore është paraqitur si çështje paraprake, dhe kjonuk ka qenë në kompetencë të t'paditurës por në kompetencë gjyqësore penale. E paditura ka pasur mundësinë që ta rishikojë vendimin e vet mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës në momentin kur gjykata e shkallës së parë paditësin e ka shpallur të pafajshëm dhe ta anulon atë, mirëpo këtë veprim nuk e ka bërë, prandaj edhe në këtë drejtim e paditura me aktvendimet e saj ka bërë shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë.

Gjykata ka vlerësuar edhe specifikacionin e të ardhurave personale sipas të cilit nëse paditësi do të kishte punuar prej periudhës nëntor 2006 e deri në dhjetor 2013, do ti realizonte të ardhurat në shumë prej 22.470,58 Euro, kontributin në trust pensional në shumë prej 1.222,25 Euro dhe tatimin në të ardhura 752,17 Euro ose gjithsej paga bruto 24.445 Euro, ndërsa për të ardhmen nga data 01.01.2014 në shumë prej 297,25 Euro, kontributin në trust 16,25 Euro dhe tatimin 11,50 Euro ose në bruto 325 Euro, të cilën palët ndërgjyqëse nuk e kanë kontestuar, prandaj duke u nisur nga parimi se palët e kanë pranuar këtë provë, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësi ka pësuar dëm material si pasojë e veprimeve të ndërmarra nga e paditura. Gjykata ka vlerësuar edhe kundërshtimet e të t'paditurës sa i përket bazës juridike të kërkesëpadsisë por të njëjtat janë të pabazuara me arsyetim se me aktvendimet e saj e paditura e ka paragjykuar prezumimin e pafajësisë, kështu që e paditura në procedurën disiplinore është dashur që pas marrjes së aktvendimit për largim të përkohshëm nga puna, të mos vendos lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, por të pres përfundimin e procedurës gjyqësore penale. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata e shkallës së parë e mbështeti në dispozitën e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduar, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 154 dhe 155 të LMD-së, të cilat i ka përdorë si bazë që ta aprovojë si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj pagat nga momenti i largimit të tij nga vendi i punës.

Gjykata e Apelit një qëndrim dhe përfundim të tillë e gjen si të gabuar sepse gjykata e shkallës së parë si fakt vendimtar për ta gjetur si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit e ka vlerësuar liruar e paditësit nga përgjegjësia penale, duke gjetur se vendimi penal e obligon gjykatën që të vendosë si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar. Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë sepse me dispozitën e nenit 14 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) përcaktohet se: *"Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimi të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor"*. Nga kjo dispozitë rrjedh se gjykata civile është e lidhur me aktgjykimin penal vetëm sa i përket veprës penale dhe përgjegjësisë penale të kryerësit, por në rastin konkret gjykata do të duhej të vlerësonte nëse veprimet e paditësit janë kualifikuar si shkelje të detyrave të punës që tërheqin përgjegjësi disiplinore për të cilën përgjegjësi disiplinore mund të shqiptohen masat adekuate disiplinore. Pra thënë thjesht veprimet apo mosveprimet e punonjësit mund të kategorizohen në grupin e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë shkelje disiplinore por që nuk përbëjnë vepër penale, prandaj në këtë rast fakti se paditësi është liruar nga përgjegjësia penale nuk nënkupton se ai është liruar nga përgjegjësia disiplinore.

Nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara konstatohet se e paditura me aktvendimin e datës 22.11.2006, Nr.1009/2, i ka ndërprerë paditësit marrëdhënien e punës në pajtim me dispozitën e nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi b) të Rregullores për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe dispozitave nga neni 2 dhe 6, neni 63 pika 6 dhe 7 e Rregullores mbi Marrëdhëniet e Punës në Hekurudhat e Kosovës.

Duke vendosur sipas ankesës së paditësit Komisioni për Shqyrtimin e Lutjeve dhe Ankesave i të paditurës me vendimin nr.1151/2, i datës 27.12.2006, e refuzon si të pabazuar ankesën e tani paditësit dhe e vërteton aktvendimin e Komisionit Disiplinor Nr.1009/2, i datës 22.11.2006. Pas këtij vendimi paditësi i është drejtuar gjykatës. Nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në kuadër të t'paditurës në pozitën e punëtorit të sigurimit. Rrethanë kontestuese është paraqitur rrethana e vjedhjes së naftës në lokomotivën 007 me datë 24.10.2006, por nuk është kontestuar nga paditësi se i njëjti ka blerë naftë dhe se ngarkimin e kanastrave me naftë e ka vendos në trenin e udhëtarëve, vagoni-bagazh dhe me rastin e nisje së trenit prej Hanit të Elezit naftën e ka fshehur në WC-bagazh. Nuk është kontestuar as rrethana se nafta është gjetur nga punëtorët e sigurimit me rastin e kontrolles së realizuar me datën 24.10.2006.

Gjykata e Apelit konstaton se e paditura me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, ndërprerje e marrëdhënies së punës, ka pasur në vlerësim rrethanat e sipërcituara të cilat nuk kanë qenë kontestuese nga paditësi (konfirmohet nga referati i padisë dhe procesverbali i dëgjimit të paditësit, i datës 10.11.2006, i mbajtur nga shqyrtimi i Komisionit Disiplinor), të cilat sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë rrethana të mjaftueshme të cilat provojnë se veprimet e paditësit kanë qenë veprime të kundërligjshme të cilat tërheqin përgjegjësi disiplinore për paditësin në proporcion me natyrën e shkeljeve.

Sipas dispozitës së nenit 11 paragrafi 3 pika b) e Rregullores për Ligjin Themelor të Punës parashihet se në kategorinë e rasteve të rënda të sjelljes së keqe parashihet vjedhja, shkatërrimi, dëmtimi ose shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë së punëdhënësit, ndërsa me Rregulloren e Marrëdhënies së Punës për Hekurudhat e Kosovës neni 62 paragrafi 2 parashihet disponimi i paligjshëm i mjeteve, ndërsa në paragrafin 6 parashihet keqpërdorimi i autorizimeve dhe tejkalimi i autorizimeve të dhëna, të dy këto veprime kualifikohen në grupin e shkeljeve të rënda në grupin e punës.

Gjykata e Apelit duke iu referuar dispozitave të cituara të Rregullores për Ligjin Themelor të Punës dhe Rregullores për Marrëdhënien e Punës për Hekurudhat e Kosovës, gjen se veprimet e paditësit kualifikohen në grupin e veprimeve që përbëjnë shkelje të rënda të detyrave të punës për të cilat shkelje masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës është ekuivalente me natyrën e shkeljes dhe rrjedhimisht edhe me Rregulloren e Komunikacionit të Hekurudhave të Kosovës, në mënyrë specifike me dispozitat e nenit 19 të kësaj rregulloreje, me të cilat përcaktohet radhitja e vagonëve të ngarkuar me materie të rrezikshme dhe detyrimi që dërgesat me materie të rrezikshme të cilat me kusht pranohen për transport të shënohen në fletën e rrezikut. Në këtë kontekst është e evidente se nafta e ngarkuar nga paditësi në vagonin e udhëtarëve është materie e rrezikshme, vendosja e së cilës në vagon të udhëtarëve do të duhej të parandalohet pikërisht nga paditësi si punëtor i sigurimit tek e paditura, e jo nga vetë ai materie të tilla të vendosen në vagon, prandaj me të drejtë e paditura pretendon se paditësi i ka keqpërdorë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës edhe për faktin së paditësi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar pronën/pasurin e të paditurës.

Ashtu siç është theksuar më lartë fakti se paditësi është liruar nga përgjegjësia penale në vlerësimin e Gjykatës së Apelit nuk përbënë rrethanë për një vendim ndryshe nga mënyra se si ka vendosur Gjykata e Apelit sipas këtij aktgjykimi.

Me qenë se nuk ekziston bazë për anulimin e vendimeve dhe kthimin e paditësit në punë, atëherë edhe kërkesa për kompensim të pagave është e pabazuar.

Për shpenzimet e procedurës u vendos në pajtim me dispozitën e nenit 450 të LPK-së, duke vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta, pasi që e paditura nuk i kishte kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 par 1, pika (e) e lidhur me nenin 201 të LPK-së, u vendos si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 2439/14, me datë 20.09.2016

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v